



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 06.05.2019, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11175, datë 19.04.2019 për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 20/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.

**Marrin pjesë:**

Ermonela Felaj, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Pjerin Ndreu, Myslim Murrizi, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Spartak Braho, Elona Hoxha, Edmond Rrushi, Lefter Maliqi, Xhemal Qefalia dhe Ylli Shehu

**Mungon:**

Paulin Sterkaj

**Të ftuar:**

Sandër Lleshaj - Ministër i Brendshëm

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Bledar Dervishaj - Këshilltar i Presidentit të Republikës së Shqipërisë për Çështjet Ligjore

## HAPET MBLEDHJA

**Ermonela Felaj** – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11175, datë 19.04.2019 për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 20/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”. Për të diskutuar rreth dekretit, por, natyrisht, edhe për të vendosur për dekretin e Presidentit të Republikës kemi të ftuar në Komisionin e Sigurisë kemi ministrin e Brendshëm, zotin Sandër Lleshaj. Faleminderit, zoti Lleshaj për prezencën tuaj në komision! Zëvendësministrin e Brendshëm, zotin Julian Hodaj, dhe nga institucioni i Presidentit të Republikës kemi këshilltarin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për Çështjet Ligjore, zotin Bledar Dervishaj. Faleminderit dhe mirë se keni ardhur!

Ndërkohë, ministri i Brendshëm shoqërohet edhe nga këshilltarja, zonja Arlinda Hoti. Faleminderit!

Në fakt, relator për ligjin “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimeve për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, ka qenë zoti Pjerin Ndreu. Kështu që edhe për dekretin dhe qëndrimin si relator do ta mbajë zoti Ndreu.

Si fillim dua të ftoj zotin Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës, për të parashtruar argumentet që Presidenti i Republikës ka përcjellë nëpërmjet dekretit për kthimin për rishqyrtim, që pak më herët janë bërë në ligjin e njohur si ligji “Për vetingun në Policinë e Shtetit”. Medies i lutem që të mbajë pak qetësi, që ne të bëjmë detyrën tonë.

Zoti Dervishaj, kuptohet që të gjithë anëtarët e komisionit e kanë përpara dekretin dhe janë të njohur. Kështu që do t’ju lutesha që të na bënit një përmbledhje të të gjitha argumenteve që janë sjellë nga institucioni i Presidentit të Republikës.

**Bledar Dervishaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë të Komisionit të Sigurisë,

Do t’i them në mënyrë të përmbledhur parashtresat për mbrojtjen e dekretit të Presidentit të Republikës, pasi, ashtu siç ju e thatë, i gjithë materiali arsyetues i dekretit, prej 9 faqesh, disponohet nga komisioni dhe nga anëtarët e nderuar të tij.

Presidenti e ka shqyrtuar ligjin nr. 20/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për vetingun në Policinë e Shtetit dhe vlerësimin kalimtar dhe periodik” dhe në përfundim ka vendosur, me dekretin nr. 11175, datë 19.04.2019, për kthimin e tij për rishqyrtim. Faktikisht shqyrtimi i këtyre ndryshimeve në ligj u bë duke iu referuar dokumenteve parlamentare të kësaj nisme, por edhe nismës, së mëparshme që nuk daton para një viti, për të krahasuar qëllimin për ndërmarrjen e këtij propozimi. Nëpërmjet ligji të miratuar së fundi, që është kthyer për rishqyrtim, realisht shkrihen dy nga strukturat e rivlerësimit kalimtar, ajo e komisionit qendror dhe komisioneve vendore dhe kompetencat që këto struktura kishin i kalojnë Shërbimit të Kontrollit për Çështjet e Brendshme pranë ministrit të Brendshëm.

Një tjetër ndryshim thelbësor është afati i procesit të rivlerësimit kalimtar, i cili do të përfundonte brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit bazë, pra e ligjit nr. 12/2018, me ndryshimet e bëra është hequr dhe në këtë mënyrë ky afat nuk është më i përcaktuar se kur do të përfundojë.

Pa u zgatur në qëllimet e nismës, mbështetja e këtij propozimi është bërë për dy arsye bazë: arsyen ekonomike, për të ulur kostot e realizimit të këtij procesi dhe për mospërmbylljen dot brenda afatit të caktuar në ligjin e mëparshëm të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Presidenti i Republikës ka vlerësuar, në gjetjet e tij, se dispozitat e ligjit nr. 20/2019, pra të këtij ligji që po rishqyrtohet sot, cenojnë standardet e vendosura nga ligji ekzistues, si dhe krijojnë terren të përshtatshëm që ky proces të ndikohet politikisht.

Mekanizmi i ri, i miratuar në ligjin nr. 20/2019, sipas të cilit Shërbimi i Kontrollit për Çështjet e Brendshme do të kryejë vlerësimin kalimtar, pra vetingun, nuk garanton standardin e vendosur për realizimin me objektivitet të këtij procesi dhe me paanshmëri. Ndryshimet e miratuara nuk krijojnë garancitë e nevojshme, që një proces kaq i rëndësishëm, me rëndësi të lartë publike, do të realizohet me objektivitet, me paanshmëri dhe në këtë mënyrë ky është një hap pas në raport me standardet e ligjit në fuqi.

Vlerësimi kalimtar i forcave policore përbën një interes të lartë publik dhe mekanizmat që duhet të realizojnë atë duhet të jenë sa më larg ndikimit politik, në mënyrë që ato të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të pandikuar, me qëllim që integriteti tërësor i këtij procesi të garantohet.

Mungesa e fondeve për të realizuar procesin me strukturat ekzistuese nuk është një argument objektiv në vlerësim të Presidentit të Republikës. Këto ndryshime në ligj krijojnë bindje

te Presidenti i Republikës se qëllimi real i qeverisë në ndërmarrjen e kësaj nisme nuk është zvogëlimi i kostove financiare për realizimin e këtij procesi, por vullneti i shprehur i saj për ta kontrolluar atë.

Ligji i kthyer nga Presidenti për rishqyrtim eliminon detyrimin ligjor që ky proces duhet të përfundojë brenda një kohe të caktuar. Proceset e rivlerësimit kalimtarë janë procese transitore, të cilat duhet të përfundojnë brenda një afati të caktuar, pasi në të kundërt ato cenojnë standardin e sigurisë juridike. Në mungesë të mundësisë për ta përmbyllur brenda afateve ligjore, pra afatit që ishte përcaktuar në ligjin e mëparshëm, 24 muaj, Kuvendi apo edhe qeveria mund të kishin rivlerësuar shtyrjen e tij, por jo që ta hiqnin fare kufizimin dhe në këtë mënyrë bëhet e paditur për çdokënd se kur ky proces do të përfundojë.

Konkretisht, mospërcaktimi i afatit se kur përfundon procesi i vetingut në Policinë e Shtetit krijon rrezikun e ndikimit për presion të vazhduar ndaj veprimtarisë së përditshme të forcave policore, si dhe mund të zgjasë kohën e qëndrimit brenda këtyre strukturave të elementëve, të cilët nuk e meritojnë të qëndrojnë brenda saj.

Këtu po e përmbyll fjalën time, pa dashur që të shtyj më tej arsyetimin, i cili është shterues në dispozicion të komisionit.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Dervishaj, për faktin që arritët të ishit i përmbledhur në të gjitha argumentet që Presidenti i Republikës ka shprehur në dekretin e tij!

Dua të vë në vëmendjen e kolegëve se kompetenca e dekretimit të ligjeve, natyrisht është një kompetencë kushtetuese që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ia jep Presidenti i Republikës. Presidenti i Republikës është i detyruar që ta shpallë ligjin brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij. Në rast se nuk shprehet me dekret brenda 20 ditëve ligji quhet i shpallur, ndërkohë që Presidenti i Republikës, sipas nenit 85 të Kushtetutës, ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm 1 herë. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e ligjit e humbet fuqinë nëse kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Pra, kjo është ajo që parashikon Kushtetuta jonë në raport me dekretin.

Përpara se t'ia jap fjalën zotit Ndreu, dua që të kemi edhe qëndrimin e Ministrisë së Brendshme në lidhje me argumentet e shprehura nga Presidenti i Republikës. Kujtoj se ligji për vetingun ka qenë një ligj sensitiv, të cilit ne si komision përgjegjës jemi munduar t'i kushtojmë të

gjithë rëndësinë dhe kohën e duhur në dispozicion për të qenë sa më objektiv në shkrimin e atij ligji.

Fjala është për ju, zoti Lleshaj.

**Sandër Lleshaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ligji është i njohur për ju, sepse ka kaluar në këtë komision të nderuar dhe është miratuar, kështu që unë nuk dua të ndalem në përmbajtjen e ligjit, por dua të komentoj shkurtimisht komentet e Presidentit lidhur me këtë ligj.

Në thelb, ashtu siç u përmend edhe nga parafolësi, shqetësimi i Presidentit të Republikës lidhet me pretendimin se ndryshimet e bëra në ligj prekin në thelb substancën e ligjit dhe standardet mbi të cilat është ndërtuar ligji. Dua të them shkurtimisht diçka rreth saj.

Së pari, ligji, tashmë i miratuar nga Kuvendi, në thelb nuk ka cenuar aspak përmbajtjen e ligjit të mëparshëm dhe përpjekja për të ndryshuar ligjin lidhet vetëm me aspektet teknike, të cilat kanë të bëjnë me afatin e vlefshmërisë së ligjit, për arsye se ligji e mbaron efektshmërinë e tij në muajin mars të vitit të ardhshëm dhe koha në dispozicion për të bërë vetingun e rreth 14000 punonjësve të policisë është fizikisht e pamundur. Pra, ligji automatikisht del jashtë vlefshmërisë së tij, ndërkohë që deri në muajin mars të vitit të ardhshëm besoj se askush nuk mund të ketë iluzione që procesi mund të mbyllet.

Për sa i përket pretendimit për prekjën e ligjit, në thelb të ligjit parashikohen tri komisione: Komisioni i Jashtëm për në fazën e parë, i cili përbëhet nga 15 komisionerë ose vlerësues dhe 15 vetë staf sekretarie, i cili qëndron nga fillimi deri në fund të procesit. Pra, në fazën e parë, të dytë dhe të tretë, thelbi i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, të cilët janë njerëz të jashtëm të ardhur nga struktura të ndryshme, nga bota akademike, ILDKPI e të tjera me radhë, qëndrojnë në të tria faza. Çfarë ndodh me përfundimin e fazës së parë, gjatë së cilës bëhet vetingu i kreut të Policisë së Shtetit?! Punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës apo të SHÇBA-së, që kalojnë vetingun, një pjesë e tyre shndërrohen në komisionerë në fazën e dytë, pastaj zhvillohet faza e dytë, e cila kryesisht merret me nivelin e drejtorive dhe të shefave të sektorëve nga drejtoritë e qendrës dhe në bazë. Në fazën e tretë këtij komisioni të këtij niveli të dytë i shtohen të tjerë që kanë kaluar vetingun nga Policia, nga Garda dhe nga SHÇBA-ja dhe formohet struktura e nivelit të tretë, vendore, e cila bën vetingun e pjesës së mbetur të policisë. Pra, cili është thelbi, sepse u theksua që është prekur thelbi?! Thelbi është Komisioni i Jashtëm, pjesa e verdhë, që qëndron gjatë

gjithë kohës këtu, të cilës i shtohen nga anash pjesa blu, që është pjesë e Policisë së Shtetit, e SHÇBA-së dhe e Gardës, të cilët kanë kaluar vetë vetingun. Me ndryshimin që bëjmë ngelet po i njëjti komision i jashtëm dhe nga anash shtohen jo vetëm punonjës nga të gjitha strukturat e Ministrisë së Brendshme, por vetëm nga një strukturë, që është SHÇBA-ja. A është prekur thelbi dhe pavarësia e ligjit ose e vetingut nga kjo?! Aspak. Pse?! Sepse personat që i bashkohen Komisionit të Jashtëm janë edhe në ligjin e vjetër, edhe në ligjin e ri persona të strukturave të Ministrisë së Brendshme. Pra, në të dyja versionet janë persona të SHÇBA-së, të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës. Në qoftë se ne pretendojmë se është prekur pavarësia e procesit, sepse personat e fazës së dytë dhe të tretë janë në varësi të ministrit, atëherë edhe me ligjin e mëparshëm kjo pavarësi është prekur, pasi personat që do të bëjnë këtë proces janë në varësi të ministrit, sepse janë ose Policia e Shtetit, ose Garda e Republikës, ose SHÇBA-ja dhe kjo bie. Unë e refuzoj këtë argument edhe për një arsye tjetër, sepse këtu merr ngjyrën e një paragjykimi fakti se paragjyket Ministria e Brendshme si një institucion, i cili dëmton pavarësinë e një procesi. Duhet ta kemi parasysh dhe vlen për ta përmendur se Ministria e Brendshme është një institucion i rëndësishëm kushtetues i vendit, i cili ka përgjegjësi shumë herë më të madhe dhe shumë herë më të rëndësishme sesa menaxhimi i një procesi të vetingut. Ky është argumenti i parë. Standardi nuk është prekur në mënyrë kategorike. Kjo për arsyen se do të jenë po të njëjtat struktura që do të bëjnë procesin. Pse e kemi bërë këtë ndryshim?! Sepse sistemi i vjetër do të na kërkojë që në fazën e tretë ne të kemi 270 persona, kryesisht të niveleve të larta drejtuese, të cilët shkëputen nga detyra e tyre dhe do të bëjnë vetingun për pjesën e mbetur, por të heqësh 270 funksione të larta drejtuese nga Policia e Shtetit dhe ta dedikosh këtë kategori drejtuesish për vetingun, do të thotë të bësh një ndërhyrje të thellë në funksionalitetin e vetë policisë, e cila duhet të merret me punë të tjera. Ndërkohë ne themi që, meqenëse Ministria e Brendshme ka një strukturë të dedikuar për vetingun, që është SHÇBA-ja, në fazën e dytë dhe të tretë SHÇBA-ja të angazhohet plotësisht dhe të bëjë detyrën që i takon me ligj, sepse SHÇBA-ja është një strukturë vetingu, e cila është krijuar për veting dhe do të ekzistojë për të bërë vetëm vetingun. Është krijuar një lloj iluzioni sikur çfarë po ndodh me vetingun, që ne tashmë e quajmë proces të vlerësimit kalimtar. Është më rëndësi të themi se vetingu është një proces që nuk mbaron kurrë, sepse, nëse ne pretendojmë që e bëjmë vetingun sot, i kaluam njerëzit, ditën e nesërme rreziku i komprometimit të personit është aty dhe dikush që ka kaluar një herë vetingun nesër mund të komprometohet. Nuk duhet të harrojmë se çdo hyrje në Policinë e Shtetit i nënshtrohet një procedure vetingu, që e bën SHÇBA-ja. Kjo do të

thotë se procesi është i pandërprerë, pavarësisht se ky ligj është kalimtar dhe struktura që ka për mision ligjor ta bëjë vetingun e pandërprerë është SHÇBA-ja, e cila do ta bëjë përherë. Në këtë kuptim, me gjithë respektin që kam për përfaqësuesit e Presidentit, pretendimi se SHÇBA-ja komprometon procesin është përtej absurdit. Kjo për arsyen se paragjykohet struktura, e cila ka detyrë të bëjë vetingun e përhershëm të Policisë së Shtetit sot, nesër e përherë. Në qoftë se kemi pretendim ose paragjykim që SHÇBA-ja është një strukturë që nuk bën dot vetingun, atëherë duhet të atakojmë ligjin e SHÇBA-së dhe të themi se vetingun do ta zgjidhim në një mënyrë tjetër, i cili është proces i përhershëm.

Dua të them edhe dy fjalë lidhur me bindjen presidenciale, e cila është shprehur dhe ka krijuar bindjen se, në qoftë se procesi është nën varësinë e Ministrisë së Brendshme, do të komprometohet politikisht dhe do të keqpërdoret politikisht e të tjera me rradhë. Kjo mënyrë argumentimi duhet të ketë shumë vëmendje, sepse nuk mund të lejohet të paragjykohet nga askush, qoftë edhe nga Presidenti, një institucion kushtetues, siç është Ministria e Brendshme. Ministria e Brendshme ka përgjegjësinë kushtetuese që të mbajë, të drejtojë dhe të udhëheqë veprimtarinë e të gjitha organeve që ka në varësi të saj, të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, SHÇBA-së, strukturave të tjera e me rradhë, të cilat janë nën varësi të Ministrisë së Brendshme pikërisht për t'u drejtuar politikisht, jo në kuptimin partiak, por në kuptimin e politikës shtetërore. Është krejtësisht e papranueshme që të pretendosh se kemi një paragjykim dhe një paranojë nga një institucion kushtetues që është Ministria e Brendshme. Sigurisht që Ministria e Brendshme bën drejtimin politik dhe udhëheqjen politike të të gjitha këtyre strukturave. Këtë e kërkojnë Kushtetuta dhe i gjithë sistemi politik që kemi sot në fuqi. Nuk mund të paramendohet që të krijohen struktura jokushtetuese, duke u nisur nga paragjykimi që ministritë nuk e bëjnë punën, kështu që do të shpikim instrumente të tjera jashtë Kushtetutës, me atë ndajshtimin “të pavarur”, që të na bëjnë një proces objektiv. Në thelb, ne duhet të rrimë brenda linjës kushtetuese, e cila parashikon institucionet si struktura përgjegjëse për të realizuar një proces të pavarur.

Për sa u përket pretendimeve për pavarësinë e procesit, duhet të kemi parasysh se kjo pavarësi jepet nga ligji dhe nuk varet nga strukturat.

Ligji u ka dhënë status të pavarur të gjithë personave që përfshihen në procesin e vetingut, ashtu sikur u jep garancinë përkatëse që ky proces të zhvillohet në kushtet e integritetit dhe pavarësisë së plotë. Pra, nuk mund t'i pranojmë në mënyrë kategorike argumentet që drejtimi i procesit nga Ministria e Brendshme rrezikon vetë procesin. Jo, është e kundërta, pra do të ishte

problem në qoftë se kërkojmë procese, të cilat janë jashtë institucioneve. Proceset janë të besueshme atëherë kur zhvillohen nga institucionet, të cilat kanë përgjegjësi kushtetuese për t'i kryer ato.

Përmbledhtas po them edhe një herë: argumenti për pavarësinë është (tani s'po e përdor prapë atë që thashë në fillim, absurdin) përtej çdolloj arsytimi, për arsye se procesi edhe në ligjin e vjetër, edhe te ligji i ri, është parashikuar të kryhet nga të njëjtët persona, nga të njëjtat struktura, pra nga struktura brenda Ministrisë së Brendshme, nga SHÇBA-ja, policia, Garda dhe Komisioni i Jashtëm.

Pretendimi i Presidentit është se, në qoftë se i japim më shumë kohë procesit, i vëmë nën presion njerëzit që janë në proces vetingu. E thashë edhe njëherë: vetingu është një proces që do të vazhdojë edhe kur të mbarojë ky ligj.

Kështu që, nëse ne kemi njerëz që do të jenë apo ndihen nën presion prej vetingut, shumë mirë, le të ndihet nën presion kushdo që ka arsye për t'u ndier nën presion. Ky presion do të vazhdojë përherë mbi Policinë e Shtetit, mbi Gardën e Republikës, mbi vetë SHÇBA-në. Kushdo duhet të ndihet nën presion, nëse ka një problem që lidhet me vetingun. Nuk është argument "që të kemi një afat, sepse nga ajo ditë e tutje njerëzit të çlirohen". Njerëzit nuk kanë arsye pse të çlirohen, ata që nuk kanë ndonjë mizë nën kësulë. Të tjerët janë të çliruar edhe sot. Shumica absolute e Policisë së Shtetit nuk janë as sot nën presion nga vetingu, sepse nuk presin të ndodhë asgjë nga vetingu, sepse ata janë njerëz që kryejnë me devocion, integritet e profesionalizëm punën e tyre dhe vetingun e konsiderojnë si një proces teknik, në të cilin do të hyjnë, do të dalin, do të certifikohen dhe do të vijojnë më tej punën pa asnjë problem.

Në përfundim, duke ju falënderuar për vëmendjen, duke ju kërkuar edhe ndjesë që e zgjata pak, ju ftoj që t'i qëndroni vendimit të mëparshëm për ta lënë në fuqi ligjin dhe për ta rrëzuar dekretin e Presidentit, për arsye se nëpërmjet këtij ligji jemi të sigurt që i japim një ritëm të ri procesit. Ju sigurojmë se do ta mbyllim në një kohë sa më të shpejtë këtë proces, në mënyrë që policia ta kalojë këtë proces të domosdoshëm në kohën më të shpejtë të mundshme dhe me ritmin e duhur.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Ju faleminderit, zoti Ministër, për parashtrimin e të gjitha argumenteve të institucionit që ju drejtoni!

Dua të sjell në vëmendje të kolegëve se ne na detyron Kushtetuta, por edhe Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, në mënyrë të veçantë neni 86, që të marrim në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës. Madje, ka një afat për këtë. Komisioni i Sigurisë, si komision përgjegjës, e shqyrton dekretin për çështjet e paraqitura nga Presidenti vetëm për ato çështje dhe jo të tjera brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimi dhe detyrohet të paraqesë edhe raportin në Kuvendin e Shqipërisë. Ne jemi brenda këtyre afateve dhe duhet t'i japim një mendim seancës lidhur me argumentet tona për dekretin. Ndërkohë, edhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, edhe ministri natyrshëm u fokusuan tek argumentet pro dhe kundër ndryshimeve të përcjella në ligj.

Dua t'ju kujtoj, gjithashtu, se në dekretin që na është përcjellë ka edhe argumente që nuk lidhen thjesht dhe vetëm me përmbajtjen e ndryshimeve të sjella në ligj, por edhe me procedurën e ndjekur nga Kuvendi i Shqipërisë. Kujtoj se ndryshimet u futën në Kuvendin e Shqipërisë me procedurë të përshpejtuar dhe nuk ka asnjë gjë për të vërejtur, sepse Kushtetuta e lejon procedurën e përshpejtuar dhe e përjashton vetëm për rastin e ligjeve që miratohen me shumicë të cilësuar, të thëna në mënyrë nominale në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pra, qoftë ligji bazë, qoftë ndryshimet që u miratuan më vonë në ligjin bazë për vetingun, nuk janë ligje të cilësuar, por janë ligje që miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë. Ndërkohë, edhe Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë vendos disa limite, pra nuk mund të kalojmë përtej një numri të caktuar projektligjesh që futen në Kuvend me procedurë të përshpejtuar. Në këtë rast, kur Konferenca e Kryetarëve vendosi që ndryshimet në këtë ligj të futeshin me procedurë të përshpejtuar, natyrisht ne ishim brenda këtij limiti. Vendimi u mor në Kuvendin e Shqipërisë dhe procedura e përshpejtuar ka të bëjë thjesht me faktin që projektligji nuk qëndron 2 javë, që është rregull i përgjithshëm i qëndrimit nga momenti kur ai propozohet nga Këshilli i Ministrave, sepse kur propozohet nga deputetët ka një tjetër afat të qëndrimit i depozituar në Kuvend të Shqipërisë, por hyn menjëherë në shqyrtim. Ndërkoha, koha e diskutimit nuk limitohet nga Rregullorja, pra nuk vihen afate për këtë pjesë.

I bërë këto sqarime për faktin se të gjithë e pranojmë se ligji ka impakt, sepse prek një trupë prej disa mijëra vetash. Sigurisht që është edhe detyra jonë që t'i ballafaqojmë argumentet e institucionit të Presidentit të Republikës. Argumentet e Ministrisë së Brendshme në sapo i dëgjuam. Kështu që ftoj relatorin që të japë argumentet e komisionit, pastaj kolegët kanë të drejtë të bëjnë pyetje ose të shprehin argumentet e tyre pro ose kundër dekretit.

Zoti Ndreu, mund ta merrni fjalën.

**Pjerin Ndreu** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, pas shpjegimit të procedurës nga kryetarja dhe pas shpjegimit shterues që bëri ministri për dekretin e Presidentit për kthimin për rishqyrtim ligji, nuk do të flas shumë, por do të them ato që konstatoj në argumentet e Presidentit, të cilat nga fillimi deri në fund janë paragjykim, pra një paragjykim me argumente, të cilat më shumë ngjajnë si argumente politike sesa teknike. Në qoftë se hyjmë tek argumentet teknike, situata nuk përputhet askund me argumentet që sjell dekreti këtu, të cilat i tha ministri dhe unë jam plotësisht dakord me to. Të paragjykos ministrin dhe ta lidhësh me SHÇBA-në dhe me një rol, i cili në argumente jepet si rol negativ, sepse e nxjerr SHÇBA-në si instrument në dorën e ministrit që po kryhen një punë antiligjore, për mua kjo është e gabuar. Presidenti nuk mund ta nxjerrë këtë argument. SHÇBA-ja është një strukturë shumë serioze që ka detyra funksionale të përcaktuara. Detyrat e SHÇBA-së nuk janë detyra që vijnë me urdhra ministri, por janë detyra funksionale të mirëpërcaktuara. Në fakt, ajo që duhet thënë, të cilën e tha edhe ministri, është fakti se SHÇBA-ja ka detyrë funksionale periodike që të marrë informacion, të bëjë analizat e informacionit, të gjejë fakte dhe prova për çdo punonjës policie, i cili në kryerjen e detyrës konsumon vepra penale apo veprime të tjera antiligjore, që cenojnë dinjitetin e punonjësve të policisë. Është detyrë funksionale periodike. Madje, po ta shohim në konceptin e vetingut, kjo është struktura që ka kredencialet më të larta dhe përgatitjen profesionale më të lartë në këtë drejtim. Çdolloj strukture tjetër nuk ka përvojën apo kredencialet e kësaj strukture, madje paragjykimi që i bëhet për mendimin tim është i pavend.

Në qoftë se do të flasim për konstatimin, është plotësisht i saktë, sepse në qoftë se do të flasim për vartësi politike, po ligji që ishte? Mirë komisioni, sepse vetëm komisioni i jashtëm përbëhet nga personazhe, që nuk janë në vartësi të ministrit, por të gjitha komisionet e tjera, madje edhe dy komisionet: komisioni qendror dhe ai vendor, përbëhen nga punonjës policie. Po ta shikojmë në pikëpamjen e rrezikut të ndikimit politik, ka më shumë peshë rreziku te këta punonjës policie sesa te SHÇBA-ja. Atëherë, si mund ta përdorim këtë argument?! Nëse e përdorim atë argument, do të bëjmë vetëm diferencën: ku ndryshoi ligji që ishte me këtë që është dhe pse këta qenkan në varësi të ministrit dhe paskan rrezik, ndërkohë ata që ishin përsëri në varësi të ministrit nuk paskan rrezik? Pra, ky argument nuk qëndron dhe, siç e thashë, i ngjan më shumë argumentit politik sesa atij teknik, që do të paragjykojë një ministër, një qeveri, se ne po ndërhyjmë te një proces, të cilit nuk e kuptoj pse duhet t'i jepet gjithnjë konotacion negativ.

Flitet, gjithashtu, për kohën. Koha është përcaktuar në bazë të një analize. Pra, është bërë një analizë dhe përderisa është bërë një analizë, kjo e fundit tregon se koha është e pamjaftueshme. Atëherë, çfarë është ky argument...? Është argument që, me thënë të drejtën, më habit. Koha zgjat, sepse duhet t'u lërë më shumë kohë disa personave të korruptuar të punojnë në polici. Më falni, por ky nuk është argument!

Ore, është kohë e pamjaftueshme, sipas analizës së bërë të ligjit: nuk e bën të mundur vetingun brenda një harku kohor të caktuar. Atëherë, çfarë duhet të themi ne, duhet të sforcohemi sipas kësaj ideje...?

Në fakt, ka edhe një problem tjetër, që lidhet me detyrat funksionale të atyre oficerëve të lartë të policisë, që do të marrin pjesë si anëtarë të komisioneve qendrore dhe vendore, që lidhen me ligjin e vjetër. Por në qoftë se ne e shtrëngojmë në kohë dhe i detyrojmë këta që të punojnë me kapacitete mbi normativë, po detyrat funksionale, që kryejnë gjatë ditës këta në drejtim të disa komisariateve, drejtorive ku shkojnë? Atëherë, kjo cenon realisht cilësinë e punës në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë, për të cilat ne kemi shumë nevojë.

Implikimi i tyre, nëse do ta shtrëngojmë brenda një harku kohor, që ishte në detyrat e vetingut, është një punë suplementare, që nuk i takon si detyrë funksionale, por i ngarkon dhe u ha edhe kohën fizike, që u duhet të punojnë me ata, të paktën sipas opinionit tim. Pra, koha është bërë me analizë dhe zgjatja e kohës nuk ka lidhje me historinë apo argumentin e presidentit, që thotë: “do t'u zgjatet koha disa personave që”...

Unë jam dakord që procesi i vetingut është i vazhdueshëm, pra një proces që nuk ka kohë, edhe SHÇBA-ja pikërisht për këtë, sepse është një strukturë, që e ka detyrë permanente dhe nuk pushon së qeni me afat. Nuk ka sesi të pushojë së qeni me afat. Struktura e policisë nuk është si struktura e drejtësisë, duhet ta kuptojmë, është një strukturë më dinamike, është një strukturë që lëviz. Pra, struktura e drejtësisë është më e konsoliduar në pikëpamjen e burimeve njerëzore dhe qëndrimit në kohëzgjatje në punë, ndërsa strukturat e policisë janë tjetër gjë. Domethënë, duhet të shikojmë edhe fizionominë e institucionit. Nuk mund ta marrim për analogji atë që ndodh në drejtësi me atë që ndodh në polici.

Në rastin konkret është vullneti për të shkuar në një proces vetingu. Instrumentet, të cilët janë gjetur për ta çuar vetingun përpara na garantojnë se procesi kryhet. Ky është thelbi i gjësë. Ne nuk kemi ndryshuar asgjë.

A kryhet procesi i vetingut? Po, kryhet, por se pas kryerjes, le të supozojmë një afat: 2-3 vjet, ne nuk mund të themi se Policia e Shtetit e ka mbaruar dhe këtu jemi në një polici super të pastër, që nuk do të ketë më elemente të tilla dhe nuk do të ketë më problematika. Në fakt, problematika do të ketë për sa kohë të jetë Policia e Shtetit, pasi kjo ndodh në të gjithë botën. Policia ka probleme edhe në vendet më të përparuara të botës, sepse roli i saj në kontaktin e përditshëm me publikun dhe me zgjidhjen e problemeve, që lidhen me shkeljet e ligjit, është dinamik dhe jo një proces që pret në kohë. Nuk pret, është dinamikë dhe policit i duhet të veprojë në vend.

Ka shumë raste që, me dashje ose pa dashje, policët e shkelin edhe vetë ligjin. Pra, duke pasur dinamikë të lartë, duke pasur ngarkesë të lartë pune, duke pasur edhe stres të lartë, edhe presion të madh publik janë disa arsye që policinë e bëjnë ndryshe nga disa institucione të tjera. Prandaj unë mendoj se argumentet nuk qëndrojnë. Janë argumente politike, madje nuk kanë lidhje fare me procesin teknik dhe me thelbin e gjësë, që, në fakt, ruhet shumë mirë dhe nuk cenon absolutisht as edhe një pavarësi.

Duke ju falënderuar, kërkoj të rrëzohet dekreti i Presidentit, si i paargumentuar teknikisht.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Ndreu!

Sidoqoftë ne, si Komision i Sigurisë Kombëtare, dhe komision përgjegjës për ligjin dhe për shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës, besoj se kemi përgjegjësinë që të japim përgjigje ose të shprehim qëndrimin tonë përkundrejt secilit argument, që është parashtruar në dekretin që ka përcjellë Presidenti i Republikës.

Ka pyetje nga kolegët? Ka pyetje për të ftuarin ose për relatorin?

Po, zoti Maliqi.

**Lefter Maliqi** – Kam edhe pyetje, edhe një koment të shkurtër.

Në radhë të parë, jam dakord me dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit dhe më vjen mirë që ndjeshmëria e Presidentit ka të bëjë me sakrificat e punonjësve të Policisë së Shtetit. Këtë deklaratë e bëj këtu para jush dhe para zotit ministër, për të thënë që unë vazhdoj të jem kritik ndaj veprimeve të qeverisë dhe ndaj opozitës, por jam pro veprimeve dhe ligjeve që janë në funksion të shtetit, të qytetarëve dhe të gjithëve me radhë.

Zoti Ministër, po e nis me pyetjet.

Ju thatë se policët duhet të ndihen nën presion. Pyetja ime është e drejtpërdrejtë: pse duhet të jenë nën presion policët dhe jo ju, jo drejtuesit tuaj të emëruar nga politika, jo ne që jemi këtu

anëtarë të Komisionit të Sigurisë (të gjithë deputetët me radhë)? Pra, pse duhet të jenë nën presion ata policë, ndërkohë që sakrifikojnë me një pagë katërqindmijëlekëshe ose pesëqindmijëlekëshe, që përballen nëpër tubimet me protestuesit apo që rrinë ditë e natë në shërbim, në një kohë kur ne, duke filluar nga ne që jemi deputetë këtu, për të vijuar me Presidentin, Kryeministrin, ministrin e të gjithë me radhë, me një fjalë, e anashkalojmë ligjin e vetingut?!

Edhe pyetjen e dytë e kam të drejtpërdrejtë. Ju thoni, madje keni të drejtën ta mohoni, që emërimet në polici bëhen nga ana ekzekutive ose nga ana e meritave. Po jua them unë publikisht që, edhe kur ishte PD-ja, edhe tani që jeni ju, emërimet e shefave të komisariateve, të drejtorëve të policisë, atyre të qarkullimit rrugor dhe të kufirit, për të mos thënë, që nga deputetët që kemi këtu përballë, pjesa më e madhe bëhen nën ndikimin e drejtpërdrejtë të politikës. Pra, kjo është një trysni politike.

Zoti Ministër, zonja kryetare dhe zotërinj deputetë, unë jam kryekëput kundër këtij ligji, ndërkohë që jam për rishikimin e ligjit, që do të thotë: i dimë sakrificat dhe kjo është tamam trysni politike ndaj policëve, pavarësisht zgjatjes së afateve e të tjerave me radhë. Unë jam për një ligj që fillon të veprojë që nga drejtori i Përgjithshëm (s'ka problem, pavarësisht se nuk po i përmbahem pjesëve të dekretit), drejtorët dhe shefat përkatës në Drejtorinë e Përgjithshme, drejtorët e qarqeve, shefat e komisariatit të policisë, shefat e qarkullimit rrugor dhe të drejtori i SHKB-së e të tjerët me radhë. Po ashtu, jam edhe për vetingun në politikë. Ngul përsëri këmbë që vetingu duhet të fillojë nga politika. Po i marrim në qafë policët, të cilët po sakrifikojnë, ndërkohë që ne këtu s'jemi aq të pastër, ata atje janë të pastër.

Mund të mos jenë të pastër drejtorët e emëruar nga politika edhe në kohën e PD-së, edhe tani, ndërsa polici është gjynah.

Kemi bërë takime në disa drejtori dhe me disa kolegë se ne vijmë nga radhët e tyre dhe e dimë që ata janë nën trysni totale. Për këtë arsye, unë jam pro dekretit të Presidentit, për një rishikim total të ligjit dhe për vendosjen e këtyre pikave, që thashë.

Nëse ju doni që të bëjmë një ligj edhe për vetingun në polici, e bëjmë. Po ashtu jam edhe për vetingun në burgje, në dogana, në tatime, por ta fillojmë që nga politika, që nga mua, që jam këtu. Unë jam për heqjen komplet të imunitetit, jo vetëm kur bëjmë një vepër penale, që të mos mblidhemi këtu, siç u mblodhëm për zotin Tahiri apo për atë tjetrin, por të mos kemi fare imunitet. Të gjykojemi për veprat penale, si të gjithë qytetarët e tjerë.

Edhe një herë, zoti Ministër, desha një përgjigje nga ju për pyetjen: pse të mos fillojë vetingu nga ju, duke vijuar me drejtorët e emëruar nga politika?

**Ermonela Felaj** - Edhe një herë të nderuar kolegë,

Ne jemi mbledhur këtu për të diskutuar dekretin e Presidentit, jo për ligjin. Ligji është votuar. Presidenti i Republikës e ka miratuar rregullisht ligjin “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”.

Presidenti i Republikës nuk i ka dekretuar ndryshimet e këtij ligji dhe ne jemi mbledhur për të shqyrtuar këtë dekret, për të ndenjur tek argumentet dhe jo për t’u hapur në çështje që kanë lidhje me këtë ligj, sepse, siç e thashë, ligji është votuar, sikundër edhe çështjet e tjera, që kanë marrë përgjigje nga Kuvendi i Shqipërisë.

Kështu, me gjithë respektin për ju, zoti Maliqi, unë nuk do t’ia jap fjalën ministrit për t’iu përgjigjur pyetjes suaj, sepse ajo nuk ka lidhje me pyetjet që u referohen argumenteve që ka sjellë Presidenti i Republikës dhe qëndrimeve, që ne duhet të kemi në raport me to. Ju e shprehët qëndrimin tuaj për këtë dekret.

Kalojmë në diskutimet e kolegëve. Ia jap fjalën zonjës Gjebrea dhe më pas, zotit Murrizi.

Keni pyetje? Dakord.

Ju lutem më thoni më parë, që ta menaxhoj kohën ashtu siç duhet!

Urdhëroni, zoti Braho për pyetje!

**Spartak Braho** - Zoti Ministër,

Për fazën e parë thuhet se vlerësimi do të kryhet nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. Kush e përzgjedh, kush e emëron këtë komision?

Pyetja e dytë është: çfarë do të bëni me arkivin e SHÇBA-së, mbas administrimit? Ky është një organizëm shumë i rëndësishëm, por po vazhdon dhe po operon akoma me letrat e kohës së kaluar, jo vetëm 5-10-vjeçare, por akoma më përpara kësaj periudhe.

Këtu po e mbyll arsyetimin për SHÇBA-në, si një organizëm që do të vazhdojë të kryejë vetingun me idenë që ka nevojë të reformohet, sidomos në procedurat e vlerësimit të dokumentacionit, që ai disponon.

**Ermonela Felaj** - Para se t’ia jap fjalën zotit Shameti për procedurë, që të mos vihemi në pozitë, desha të sqaroj edhe një herë, se ne jemi mbledhur për dekretin. Përballë kemi institucionin e Presidentit të Republikës. Edhe një herë kolegë, që të mos vihemi në pozitë! Ne

jemi mbledhur për dekretin. Përballë kemi institucionin e Presidentit të Republikës. E kemi ftuar Ministrinë e Brendshme me argumentet dhe me qëndrimin që ne do të vendosim në fund, për të qenë sa më të hapur jo thjesht ndërmjet nesh, por edhe në raport me publikun dhe me të gjitha organizatat e Policisë së Shtetit.

Ju lutem, nuk është rasti për të bërë pyetje as për misionin e SHÇBA-së, sepse ligji është miratuar, as për qëndrime të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, ju po bëni pyetje, ndërkohë që ministri ka ardhur dhe i ka parashtruar arsyet që e çuan institucionin në propozimin për ndryshime në ligj. Ne kemi qenë pro atyre ndryshimeve, ndërkohë që Presidenti i Republikës ka një qëndrim tjetër. Ju lutem, të rrimë tek ato çështje! Nëse nuk kemi pyetje për përfaqësuesit e Presidencës për argumentet që Presidenti ka parashtruar për t'u qartësuar në lidhje me to, atëherë le të shprehim qëndrimet tona. Kjo është logjika e kësaj mbledhjeje. Unë nuk dua të vihem në pozitë, se natyrisht ministri ka të drejtë sipas Rregullores së Kuvendit ta marrë fjalën sa herë që e kërkon, por unë nuk dua të vihem në pozitë as me ju, sepse dalim jashtë rendit, as me të ftuarit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kërkoni fjalën, zoti Shameti!

**Adnor Shameti** - Faleminderit, zonja kryetare!

Sikur ma lexuat mendimin.

Për procedurë. Me gjithë respektin për të gjithë kolegët pjesëmarrës në këtë mbledhje komisioni, ashtu siç ju e ngritët, dua të ripërsëris atë që Rregullorja e Kuvendit parashikon. Sot jemi mbledhur vetëm për të miratuar apo rrëzuar përgjigjen e Presidentit të Republikës, nëpërmjet dekretit për kthimin e ligjit. Kështu, si pyetjet ashtu edhe diskutimet lidhur me këtë çështje, duhet të jenë të lidhura ngushtësisht vetëm me motivet apo me argumentet ligjore, që Presidenti i Republikës përmes përfaqësuesit ligjor të Presidencës, ka ngritur në shkresën përcjellëse të tij.

Për të tjerat, mendoj se nuk kanë asnjë lidhje me seancën e sotme. Nëse nuk ka pyetje apo diskutime që lidhen ngushtësisht me atë që ka ngritur Presidenti në dekretin e tij, ta hedhim në votim në përputhje me qëndrimin që ka mbajtur relatori i çështjes në fjalë dhe të përfundojmë seancën.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Shameti! Këtë isha duke thënë edhe unë. Ne si komision do të marrim një vendim për dekretin dhe në shprehjen e qëndrimeve tona ne nuk influencohemi, sepse nuk jemi të detyruar nga qëndrimi që mban institucioni që ka propozuar projektligjin. Ne i dëgjuam argumentet. Tani ju ftoj të bëjmë detyrën tonë, duke shprehur ne argumentet tona, sepse ne diskutimin për projektligjin dhe të gjitha pyetjet që kemi pasur në raport me vetingun e policisë, i kemi ezauruar, nuk rikthehemi më aty. Kuvendi i Shqipërisë është shprehur. Edhe po të donim ne, është Kuvendi që qëndron mbi këtë komision, që e ka marrë vendimin për këtë projektligj.

**Sandër Lleshaj** - Zonja Felaj...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zoti Lleshaj!

**Sandër Lleshaj** - Desha të them 2 fjalë, edhe pse më takon, por edhe sepse diskutimi i zotit Maliqi kishte lidhje me fjalën time.

**Ermonela Felaj** – Atëherë, jepni një përgjigje të përmbledhur për të dy kolegët dhe ta mbyllim këtu diskutimin që të kalojmë te qëndrimi për dekretin.

**Sandër Lleshaj** – Për sa i përket çështjes a duhet të ketë trysni, trysnia mbi policinë është një trysni normale, që ekziston mbi çdo qytetar të këtij vendi. Çdo ligj është një formë trysnie mbi çdo qytetar. Trysni është edhe zbatimi i rregullave të qarkullimit apo që të mos vjedhësh. Pra, nuk është kjo ajo që e dëmton policinë (ekzistenca e një trysnie ligjore, pozitive mbi këdo).

Nëse dikush ndihet i trysnuar sot në Policinë e Shtetit, patjetër që ai duhet të ketë një problem dhe nëse është kështu, le ta ketë këtë trysni. Ky ishte thelbi i fjalës sime.

Kjo nuk do të thotë që unë e paragjykoj Policinë e Shtetit. Përkundrazi, unë besoj fort, se Policia e Shtetit është një organizëm me integritet të lartë që kryen një shërbim të jashtëzakonshëm për Shqipërinë. Pa diskutim dhe më shumë se kushdo tjetër e kam këtë bindje, sepse unë e prek çdo ditë këtë realitet, por trysnia është ndaj atyre, që duhet të kenë probleme dhe kjo nuk është Policia e Shtetit.

Për sa i përket vetingut tim, zoti Maliqi, unë e kam kaluar vetingun gjatë gjithë jetës time. Në veting kam qenë edhe më parë. Që kur e kam marrë këtë detyrë, kam kaluar një veting spektakolar. Jam i hapur për veting, por edhe për më shumë se kaq.

Për sa i përket pyetjes së zotit Braho, se kush e zgjedh komisionin e jashtëm të vlerësimit, komisioni i jashtëm i vlerësimit është zgjedhur përmes një procedure konkurrimi publik përpara se

unë të merrja detyrën. Ata janë përcaktuar përmes një procedure të parashikuar nga ligji. Madje, për fat të mirë, nuk kam qenë ministër kur është zgjedhur komisioni i jashtëm i vlerësimit.

Për sa i përket arkivës së SHÇBA-së, unë e ndaj shqetësimin tuaj që arkiva ka nevojë për të zbatuar procedura të mirëfillta moderne për sa i përket vlefshmërisë së dokumentacionit, i cili, ndonjëherë, mund të përdoret ose keqpërdoret në dëm të personave të caktuar kur kalojnë afatet.

Ka pasur raste që informacione shumë të vjetra, të arkivuara, janë futur në proces, ndërkohë që të gjitha informacionet, përfshirë edhe ato policore, kanë një afat vlefshmërie. Pra, nuk mund të thuhet që ka pasur një incident apo dyshim para 20 vjetësh dhe do të procedohet sivjet. Kjo është një çështje që do të zgjidhet përmes përditësimit të udhëzimeve përkatëse të ministrit, i cili ka kompetencë për të vendosur edhe mënyrën se si do të administrohet informacioni i tejkualuar në kohë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

**Lefter Maliqi** – Zoti Ministër, ...

**Ermonela Felaj** – Zoti Maliqi, ju lutem! Ne nuk kemi këtë diskutim sot, prandaj nuk doja të futeshim në këtë pjesë.

**Lefter Maliqi** – Më fal pak!

**Ermonela Felaj** – Nuk na e lejon Rregullorja. Diskutimi nuk mund të vazhdojë koment pas komenti.

**Lefter Maliqi** – Zoti Ministër, nuk e kisha posaçërisht me ju, por me postin politik. E njoh shumë mirë ndjeshmërinë tuaj si ushtarak, por e kisha me postin politik, postet drejtuese politike, ne që jemi këtu dhe me ndjeshmërinë ndaj policëve të thjeshtë. Ky ligj është propozuar që në kohën e zotit Xhafaj.

**Ermonela Felaj** – Dakord.

Po, zonja Gjebrea. Më pas e ka fjalën zoti Murrizi.

**Elona Gjebrea** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit zoti Ministër për sqarimet e detajuara! Po ashtu falënderoj edhe institucionin e presidentit për argumentet e dhëna për kthimin e këtij projektligji!

Dua të theksoj që ndryshimet e propozuara, ashtu sikurse e tha ministri, nuk e prekin thelbin e procesit të vetingut, përkundrazi, i gjithë ky ndryshim bëhet në funksion të një procesi më të shpejtë dhe efektiv.

Për sa u përket argumenteve për kthimin e këtij projektligji, dua të theksoj që (në fakt është detyra jonë ta garantojmë procesin e vetingut) me ndryshimet e propozuara ky proces garantohej si në pikëpamjet e funksionimit të rregullt, ashtu edhe me mbështetjen e duhur dhe të arsyeshme financiare.

Dua të bëj një analogji me ligjin për buxhetin e shtetit, sepse edhe ky ligj rishikohet disa herë brenda vitit për t'iu përshtatur mbledhjes reale të të ardhurave dhe shpenzimeve publike. Në çdo rast të ngjashëm ne do të kishim një dakordësi, me një financim të arsyeshëm, që të arrihej qëllimi i zbatimit të ligjit dhe ndërkohë të ruhej balanca e financave të shtetit.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka qenë i kujdesshëm edhe në këtë pikë për faktin e thjeshtë se në Policinë e Shtetit në veçanti, nuk shikon të lidhur vetëm një nevojë, por disa të tilla, që kanë prioritetë të ndryshme mes njëra-tjetrës dhe të tjera nevoja që ka shteti.

Për sa kohë që krimi sofistikohet, është detyra dhe përgjegjësia jonë si të zgjedhur të mbështesim policinë sa më mirë financiarisht, me mjete, pajisje, infrastrukturë dhe kapacitete njerëzore, që, në fakt, është bërë edhe nga qeveria. Në 2 vjetët e fundit ka pasur rritje të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Dëshiroj të theksoj edhe faktin që ka të bëjë me pretendimin që ligji eliminon detyrimin ligjor për të përfunduar procesin e vlerësimit brenda një afati të caktuar. Ne kemi vendosur që komisioni i jashtëm i vlerësimit duhet ta përmbushë punën e vetë 1 vit nga hyrja në fuqi e ligjit. Është e rëndësishme që procesi i vetingut të gradave të larta, për të cilat është i mundur kontrolli në të gjitha parametrat, të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme.

Të dhënat e vetingut të prokurorëve dhe gjyqtarëve ndihmojnë për të kuptuar edhe vështirësinë e konkludimit të një afati final, në kushtet kur trupa e policisë që do të vetohet nga shërbimi është disafish më e madhe në numër sesa e gjithë trupa e gjyqtarëve dhe prokurorëve, këshilltarëve ligjorë e kështu me radhë. Ne si komision parlamentar kemi pasur parasysh evitimin e ndërhyrjeve të shpeshta në ligj, pasi në praktikën parlamentare është treguar që afatet shpeshherë nuk janë respektuar dhe është dashur që në ligje të ndryshme të ndërhyhet vetëm për çështjet e zgjatjes së afateve, gjë e cila nuk është korrekte, as impenjimi i parlamentit vetëm në çështje të kësaj natyre. Në këtë mënyrë Kuvendi i Shqipërisë, duke vendosur me ligj krijimin e nënkomisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të ligjit të Vetingut, ku unë bëj pjesë, me përbërje të maxhorancës dhe të opozitës, ka ofruar një garanci të qartë dhe të mjaftueshme që vetingu i gjithë trupës së Policisë së Shtetit nga shërbimi të ushtrohet brenda afateve të arsyeshme, përtej çdo

keqpërdorimi dhe ndikimi të paligjshëm, duke shmangur kështu çdo lloj dyshimi se mungesa e një afati konkret për rastin në fjalë do të çojë në minim nga qëllimi i pandryshuar i ligjit, të cilin po e diskutojmë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Gjebrea që u përqendruat te argumentet!

Argumenti financiar ka qenë një argument i parashtruar edhe nga ana e Ministrisë së Brendshme, kur propozoi ndryshime, por i marrë në shqyrtim edhe nga Presidenti i Republikës në dekretin e tij, sikurse edhe çështja e afatit.

Kujtoj që për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit nuk ka pasur afat ligji bazë, ligji i parë që kemi miratuar për vetimin e punonjësve. Ka pasur vetëm një afat të përgjithshëm të vetimit që vlente për të gjitha komisionet dhe për të gjithë trupën e policisë, që ka qenë një afat dyvjeçar. Është propozuar nga Ministria e Brendshme që ky afat të mos ishte, për arsyet që edhe ministri i përmendi në fjalën e tij. Ne në këtë komision e kemi mbështetur, ndërkohë që ka qenë ky komision që ka propozuar afatin njëvjeçar për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, afat që e detyron komisionin që brenda një viti të votojë të gjitha gradat e larta, pra rreth 300 grada të larta në Policinë e Shtetit. Këtë afat kemi vendosur ne.

Po ia jap fjalën zotit Murrizi.

**Myslim Murrizi** - Faleminderit!

Nuk është rasti i parë që Presidenti i sotëm apo presidentët e mëparshëm kthejnë ligje. Të paktën, nga ndryshimet kushtetuese të prillit të vitit 2008, presidentët herë-herë, kushdo që ka qenë, për të treguar se nuk është noter vetëm për të legalizuar atë që çon maxhoranca, kthen ndonjë ligj.

Pse është kthyer ky ligj apo pse janë kthyer ligje të tjera? Presidenti i Republikës është në të drejtën e tij kushtetuese. Ashtu e ka gjykuar dhe mirë ka bërë. Unë, personalisht, duke qenë këtu edhe kur është kaluar ligji i parë, ligji bazë, kam qenë kundër ligjit për faktin e thjeshtë se pashë një vrull propagandistik, politik, demagogjik të vetingut të famshëm të drejtësisë, i cili u trumbetua sikur do të ishte shkopi magjik i zgjidhjes së halleve të qytetarëve.

E kam thënë edhe herën tjetër, kur ishte zoti ministër këtu, por edhe kur ka qenë ministri Xhafaj, se unë nuk besoj që ligjet janë ato që zgjidhin problemet e kriminalitetit apo të korrupsionit, si në polici, ashtu edhe në çdo institucion tjetër. Po të ishte kështu, kishim bërë ligje që të funksionojë shteti vetëm me parlament dhe nuk do të kishte nevojë për agjenci ligjzbatuese.

Duhet ta pranoni që çdo ligj që i sanksionohet Kushtetutës, që kalon me shumicë të thjeshtë votash (nuk kemi pse fshihemi pas gishtit), pasqyron drejtpërdrejt vullnetin politik të programit të asaj force politike që është në qeveri. Pse e anashkaloni sikur po bëni ligj mbi palët? Ky është një ligj ku jeni shprehur vullnetin tuaj politik, sepse policët nga viti 2013 deri në vitin 2017 u bastarduan në roje hashashi. Keni 4 komisarë policie në kërkim, 128 drejtues të lartë (jua ka sjellë SHIK-u ministrave, paraardhësit tuaj, zoti Lleshi) të dalë nëpër përgjimet e prokurorisë si transportues, porositës, ruajtës dhe shitës të mallit. Keni një ministër të Brendshëm (kampionin) në akuzë, deri kur të vërtetohet çfarë ka bërë, keni një tjetër të larguar (të dorëhequr apo të lartuar e dini ju) dhe ju jeni i treti në rradhë.

Argumentet që pashë te relacioni shpjegues i zyrës së Presidentit, unë nuk e besoj (edhe këshilltari i Presidenti besoj se është në një mendje me mua) që Presidenti të ketë marrë lapsin në dorë dhe të ketë bërë konspekt, është dora juaj.

Ju thatë se ligji është miratuar me konsensus pozitiv–opozitë. Nuk është e vërtetë. Fakti që ligji i parë ka marrë 88 vota pro, një votë kundër dhe 32 abstenime, do të thotë se nuk është me konsensusin tonë dhe një ligj i thjeshtë nuk ka nevojë për konsensusin e opozitës se kështu ndodh në të gjithë botën në sistemet pluraliste. Po që se votojnë të gjithë, kthehemi te, largqoftë, Partia e Punës, që kujton Spartaku. Pra, nuk ka pasur konsensus dhe një argument juaji në relacion nuk është i vërtetë.

Ju thoni se nuk ka garanci të nevojshme që do të jetë i kristaltë. Ma gjeni një ligj në Shqipëri dhe në çdo vend demokratik që e jep këtë garanci maksimale për të qenë si engjëll i zbritur nga qielli sa kalon në Kuvend.

Të gjitha ligjet kështu janë nga arsyetimi logjik, se “frika ruaj vreshtin”, thotë populli, pra të bëjmë një ligj për të frenuar sa të mundemi fenomenin negativ.

Ju thoni se ky ligj nuk ka garanci të nevojshme. Ky ligj lindi thjesht, se erdhi zoti Xhafaj ministër dhe, meqë kishte qenë deputet te komisioni i famshëm i vetingut në drejtësi, i cili u bë me 140 vota dhe po e shikojmë se akoma nuk ka mbaruar, dhe për të ndërruar stafetën e kampionit, tha që të bëjmë një veting në polici.

Herën tjetër unë i kam thënë zotit ministër që pasi të mbarojë vetingu në polici, të gjithë ata që vijnë apo kalojnë këtë veting, të gëzojnë imunitet. A është vaksinë ky ligj? Nuk janë imunë ata. E merr të kristaltë ti, por sheh rrushi-rrushin dhe piqen fiqtë. Po e pa drejtorin e policisë, që përdoret si shofer autobusi për të sjellë kriminelët nga Saranda në Tiranë, si agjenci turistike

SavaTours, çfarë do të bëjë shefi i komisarariatit të Lushnjës? Do të fillojë të marrë nga trafiku i Divjakës dhe do t'i sjellë në komisariatin e Lushnjës.

Zoti Ministër, edhe herën tjetër kam qenë kundër vetingut të 1300 punonjësve të Gardës dhe të 9000 policëve në funksionin bazë. Meqë keni ardhur i vetuar, meqë e keni kryer vetingut vetë, a keni ju vullnet që t'ia filloni me 287 gradat madhore (300 tha kryetarja), nga ai i agjencisë turistike SavaTours, drejtorët që keni dhe 2700 funksione bazë? Lëreni shërbimin e brendshëm të merret me punët që ka të ngarkuar në ligjin organik, se 100 herë t'i vetoni ju këto 9000 policë, që janë roje rrushi, nuk është se vjen e keqja nga këta.

Ju duhet të kryeni vetingun e 287 kapove që japin urdhër, që kanë telefona BQ (se çfarë i duhet një drejtuesi policie telefoni BQ, telefon që blihet brenda vitit, se ka pasur edhe ministra me telefon BQ). Qërojini këto të listës, se ju i dini se cilët janë dhe mos na hidhni hi syve!

A e dini se sa hajdutë janë doganierët e tatimeve? Po te Drejtoria e Rrugëve, që e bëjnë 20 milionë euro kilometrin në autostradë? Çfarë do të bëni? Çdo ministër do të shpikë një artificë për veting? Kështu që, siç kam qenë herën tjetër kundër këtij ligji, nuk e kuptoj, edhe pas argumenteve shteruese të ardhura nga relacioni shpjegues i Presidentit, nuk shoh që ata të prekin thelbin e qëllimit real, pse është bërë ky ligj. Ky është një ligj që maxhoranca e ka gjykuar kështu, a për të pastruar policinë, a për t'u hedhur hi syve atyre që i kanë parë si roje të hashashit ose për të zgjatur jetën e saj, kështu e ka gjykuar maxhoranca. Ligji kërkon shumicë të thjeshtë. Çdo ligj që kërkon shumicë të thjeshtë është në dorën e atyre që kanë shumicën e kartonëve në Kuvend. Janë 4 vjet, sovrani do ta gjykojë nëse i kanë bërë mirë këto ligje apo jo te vota.

**Ermonela Felaj** – Vetëm një sekondë! Për të qenë korrektë ligji është votuar jo nga e gjithë opozita, por nga Lëvizja Socialiste për Integrim. Me siguri që Presidenti i Republikës këtë ka pasur parasysh kur ka shprehur fjalën “opozitë”. Ka qenë propozim i Lëvizjes Socialiste për Integrim edhe i mbështetur nga disa deputetë të Partisë Demokratike në këtë komision, që të kishte një nënkomision parlamentar për monitorimin e zbatimit të ligjit për vetingun, për shkak se ne e pranuan këtë qëndrim si maxhorancë në Kuvendin e Shqipërisë, jo në këtë komision, në këtë komision nuk e kemi pranuar, sepse e kemi votuar këtë sugjerim, u ngrit ky nënkomision. Është rasti t'i ftoj kolegët e opozitës që t'i depozitojnë emrat, sepse kanë edhe ata vendin e tyre në përbërjen e atij komisioni. Dy anëtarë duhet të jenë nga opozita, ndërkohë që 4 anëtarë...

**Myslim Murrizi** - I kam propozuar.

**Ermonela Felaj**- Në rregull.

Do t'ia kaloj fjalën zotit Dervishaj. Keni 10 sekonda për një qëndrim, meqenëse e kemi ftuar.

Pastaj fjalën e ka zoti Shameti.

**Myslim Murrizi-** Zonja kryetare, të njëjtin material kemi të gjithë, ku e patë që thotë për Lëvizjen Socialiste për Integrim?!

**Ermonela Felaj-** E marr me mend. Kjo ishte për të saktësuar fjalën tënde.

**Myslim Murrizi-** Ti e parashikuake për së largu Presidentin!

Unë nuk jam këtu përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim. E di që keni pasur dashuri sezonale, 6 muaj pajtoheni, 6 muaj zemëroheni, problemi është që unë nuk kam votuar, ata që keni pasur para dhe mbrapa janë jashtë.

**Ermonela Felaj-** Lëvizja Socialiste për Integrim gjithsesi është opozitë parlamentare.

**Bledar Dervishaj** – Për të parë se cila nga forcat opozitare ka bashkëpunuar në relacion është përdorur termi konkret “bashkëpunuar” forcat politike dhe jo dakordësuar, ne i jemi referuar të gjithë praktikës parlamentare. Unë e bëra hyrjen, që në fillim: “Shqyrtimi i këtij ligji iu referua praktikës së vitit të kaluar”. Në praktikën parlamentare nëse shikojmë të gjithë dosjen elektronike që Kuvendi shfaq në *website*-n e tij konstatohen: projektligji, relacioni, ndryshimet, komente, si edhe propozime një ditë para seancës plenare. Prandaj ne themi se kanë bashkëpunuar të gjitha forcat politike dhe nuk kemi thënë se kanë dakordësuar të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Ky ishte një koment i vogël, vetëm për sqarim.

**Ermonela Felaj** –Ne mund ta saktësojmë për publikun, sepse i kemi rezultatet e votimit. Kur është votuar ligji bazë “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shteti” e të tjerë, kanë qenë prezentë 123 deputetë, kanë votuar 121, nga të cilët 88 kanë votuar pro, 1 kundër dhe 32 abstenime. Kjo ka qenë pjesa tjetër e Partisë Demokratike. Për ndryshimet e propozuara në projekt për ligjin nr.20 prezenca ka qenë 88, kanë votuar pro 78, 4 kundër, 6 abstenime. Këto janë rezultatet të printuara nga sistemi.

Po, zoti Shameti.

**Adnor Shameti** - Faleminderit!

Në vijim të ndërhyrjes që bëra për procedurë, sot jemi duke shqyrtuar dekretin e Presidentit të Republikës për kthimin e ligjit “Për vetingun në Policinë e Shtetit”. Në bindjen time juridike dhe politike shkaqet ligjore të parashtruara në relacionin mbështetës të dekretit të Presidentit të Republikës për kthimin e këtij ligji janë të ndryshme nga ato që parashikon

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për kthimin e një ligji. Në vijim të sqarimit që bëtë ju si për mediet, ashtu edhe për opinionin publik se nuk ka ndryshuar asgjë në thelb nga ligji origjinal i miratuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nga to ndryshime që ne kemi paraqitur, Presidenti i Republikës nuk gjeti asnjë arsye në rastin e parë në gjuhën origjinale që pati ligji për ta kthyer atë. I tillë duhet të ishte qëndrimi i tij edhe në rastin e ndryshimeve që kaluan në Kuvendin e Shqipërisë. Argumentet e paraqitura si nga ministri i Brendshëm, me teknikalitetet e atyre gjetjeve që ishin referuar në relacionin e përfaqësuesit ligjor të Presidentit të Republikës nga njëra anë, sikurse shpjegimet shteruese të relatorit të këtij projektligji janë të gjitha të mbështetura në ligj dhe justifikojnë qëndrimin e tyre.

Në këto kushte ftoj të gjithë anëtarët e komisionit të votojmë njëzëri rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës për kthimin e këtij ligji për rishqyrtim në Kuvend.

**Ermonela Felaj**- Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** - Unë do të flas shumë shkurt pasi u ezauruan edhe nga parafolësit, por sidomos nga relatori dhe nga ministri, të cilët ishin shumë të saktë. Por dua t'ju kujtoj kolegëve që kemi përballë se ne, në kuadrin e masave dhe detyrave që ka komisioni kemi inspektuar disa nga drejtoritë e policisë së qarqeve, ku kemi bërë edhe një pyetje të tillë atje, kanë qenë prezent edhe kolegët që sot janë të pranishëm. Ky ndryshim që i është bërë ligjit të vetingut për Policinë e Shtetit, a është mirëpritur nga efektivet poshtë apo jo? Përgjigjja ka qenë pozitive. Ne duhet ta pranojmë se ka pasur njëfarë frustimi të punonjësve të policisë.

Lidhur me problemin që edhe përfaqësuesi i Presidenti mundohet ta justifikojë duke thënë: “Ka marrë pjesë opozita”.

Zoti Braho, opozita nuk është përcaktuar, por numri 88 tregon atë çfarë tha me të drejtë zoti Murrizi, që opozita nuk i voton dhe nuk ka detyrimin të votojë ndërmarrjet që bën maxhoranca, sepse opozita nuk e ka dashur as reformën administrative, as reformën në drejtësi, as reformën e pensioneve dhe as shumë gjëra të tjera të cilat kjo maxhorancë ka detyrimin t'i bëjë. Gjëja që ka bërë ministri Lleshaj, i gjithë stafi i tij që ka paraqitur këtë draft është që ky mekanizëm të jetë shumë i thjeshtë dhe i zbatueshëm. Nuk ka të bëjë aspak me politizimin. Gjëja më pavend është prononcimi i drejtpërdrejtë i Presidentit të Republikës. Nuk mund të shprehet një president republike dhe të thotë: “Kjo ka impakt politik, që ministri dhe qeveria të ndërmarrin veprimet që i interesojnë politikisht”. Presidenti shprehet në mënyrë taksative, ku ka shkelje ligjore,

kushtetuese, të cilat e zhbëjnë ligjin që ka sjellë kjo maxhorancë. Nuk më duket me vend përgjigja që dha përfaqësuesi “se ka pasur diskutime”. Po, diskutim po bëjmë dhe tani për këtë. Këtu e kemi opozitën edhe tani, por ne nuk pretendojmë se opozita do të votojë, siç voton maxhoranca. Opozita është e pranishme, ka qenë e pranishme edhe kur është miratuar para një muaji ky ligj i ri. Gjëja që duhet të bëjmë është përshpejtimi.

Meqenëse e mora fjalën, zoti Ministër edhe në seancën parlamentare kam ngritur një problem, pasi u kemi dhënë mundësi të gjithë ish-punonjësve të policisë, të cilët janë larguar në forma apo metoda, të cilat nuk dua t’i shpreh dhe t’i paragjykoj se kanë të drejtë të vetohen. Nga Komisioni i Jashtëm na është dhënë informacion se ka rreth 167 persona, të cilët kanë dorëzuar dokumentet për t’u vetuar. Ndërkohë ka mospërputhje ligjore në ligjin për policinë nuk i lejojnë të kthehen. Kjo gjë nuk është objekt i dekretit të Presidentit, por është një detyrë.

Zonja kryetare, ndoshta me një amendament apo në një formë tjetër të krijojmë mundësinë, shansin edhe për ata punonjës policie të cilët janë sot jashtë radhëve të policisë dhe kanë pranuar të vetohen njëloj si kolegët e tyre që janë në detyrë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, mund ta merrni fjalën për ndërhyrje, por kërkoni leje!

**Lifter Maliqi** - Dakord!

**Ermonela Felaj** - Për sa kohë që komisioni e ka një drejtim, besoj se për kaq kemi mundësi ta respektojmë njëri-tjetrin.

Po, zoti Maliqi!

**Lifter Maliqi** – Një ndërhyrje e vogël. Megjithëse e respektoj dhe e vlerësoj kolegun Qefalia, besoj se ato biseda që ne bëjmë në drejtoritë e qarqeve ku kemi vajtur, nuk ishin për t’u bërë këtu. Meqenëse kemi këtu edhe ministrin e Rendit, nuk dua që ndonjëri të marrë ndëshkim nga drejtuesit. Ishim aty të gjithë, dhe kundërshtoj idenë se policët e kanë mirëpritur ligjin e vetingut.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Asnjë nuk e ka mirëpritur, por drejtuesit e policisë kanë bërë shkaktar dhe fajtor ish-ministrin e Brendshëm, për nismën që ai ka ndërmarrë.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Nuk është se ne po bëjmë një testim të kësaj gjëje, sepse i kemi parashtruar arsyet se përse duhet ta bëjmë këtë ligj, si dhe përse duhet të vetohen punonjësit e policisë, ndaj vetimi nuk vihet

fare në diskutim. në diskutim vihen çështje të tjera: ishin apo s'ishin të mjaftueshme financat për ta bërë këtë ligj; a duhej apo s'duhej afati për pjesën e Komisionit të Jashtëm; a mund të ketë një lloj keqpërdorimi, po themi, të SHÇBA-së, e të tjera e të tjera?

Këto ishin çështjet që ka sjellë edhe Presidenti, por tek të cilat u ndal edhe ministri në fjalën e vet, e natyrisht edhe relatori.

Ka diskutim tjetër nga kolegët?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirë. Unë besoj se i gjithë ballafaqimi i argumenteve na ndihmon për të kuptuar natyrën e vërtetë të ndryshimeve të propozuara.

Më lejoni të shpreh një qëndrim timin në lidhje me një diskutim, me atë që bëhet për SHÇBA-në. Në fakt, SHÇBA-ja është një organ i krijuar me ligj, ka ligjin e vet organik. Në vitin 2014 kemi bërë ligj të ri në lidhje me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Policinë e Shtetit. Në momentin që ai ligj është propozuar dhe natyrisht votuar në Kuvendin e Shqipërisë, qasja ka qenë e tillë, që këtë shërbim ta afrojë sa më shumë me qytetarët. Nga ana tjetër, të mos harrojmë se misioni kryesor i këtij shërbimi, pavarësisht se varet nga ministri i Brendshëm, është që të ruajë integritetin e punonjësve të strukturave në mënyrë të vijuar, jo në mënyrë periodike. Çdo punonjës i Policisë së Shtetit, edhe sipas ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, në momentin ë rekrutohet në Policinë e Shtetit, është i detyruar të kalojë testin e integritetit, që është edhe pika më kyçe, e cila ka të bëjë me figurën e tyre.

Pse ne mendojmë se nuk ka arsye të keqpërdoret SHÇBA-ja? E para, sepse SHÇBA-ja ishte pjesë e procesit edhe pa u propozuar ndryshimet. Informacionet për figurën e çdo punonjësi të Policisë së Shtetit, natyrisht që disponohen nga SHÇBA-ja. Ne shkurtuam kohë. në vend që SHÇBA-ja t'i kalonte informacionet te secili nga komisionet, te secili nga sekretariatet, SHÇBA-ja jo për gradat e larta e jo për veten e saj, po për të gjithë pjesën tjetër, natyrisht që do ta vërë në lëvizje informacionin që ka dhe do ta rishqyrtojë për të kuptuar se ku janë punonjësit e Policisë së Shtetit në lidhje me figurën.

Të mos harrojmë: pse vendosëm ne një afat për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit? E vendosëm për arsyen e thjeshtë se ky komision do të votojë gradat e larta, dhe natyrisht, Policisë së Shtetit ia japin tonin gradat e larta, ia japin drejtuesit. Kështu, duhet të jemi shumë të drejtë dhe shumë objektivë kur flasim. Nëse ka mundësi të korruptohen, nëse janë më të hapur ndaj presioneve për t'u korruptuar a joshur nga krimi, sigurisht që drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit

janë. Ato janë pjesa më delikate, pjesa më e brishtë, pjesa ku ne duhet ta përqendrojmë vëmendjen. Prandaj vendosëm afat.

Nga ana tjetër, drejtuesit e Policisë së Shtetit janë të kontrollueshëm në të tre parametrat: kontrollohen për pasurinë, sepse kanë deklaruar që kur kemi ligjin “Për deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesave”, pra që nga viti 2003, gjë që nuk ka qenë për punonjësit e Policisë së Shtetit me grada të mesme e të ulëta. Ata nuk janë subjekte as sot e kësaj dite. Në momentin që ne miratim ligjin “Për vetingun”, ata e deklaruan rishtas pasurinë e tyre. Pra, për herë të parë kemi të dhëna të pamarrë në shqyrtim ndonjëherë nga ndonjë institucion, siç është Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurisë dhe Kontrollit të Konfliktit të Interesave.

E dyta, natyrisht që vendimet i marrin drejtuesit.

E treta, figura e tyre ka shumë rëndësi për të gjithë përmbajtjen e punës së Policisë së Shtetit.

Për këtë, ne u kujdesëm të vendosnim një afat, afat që nuk ishte as në ligjin e parë, as në ndryshimet e propozuara. Pra, nëse Presidenti ka pasur një ndjeshmëri për çështjen e afatit, ne bashkohemi në një pikë, sepse të njëjtën ndjeshmëri e ka pasur edhe Kuvendi i Shqipërisë. Por ama për këtë pjesë. Për pjesën tjetër është objektivisht e pamundur të përcaktosh një afat, kjo edhe për shkak të numrit të madh të punonjësve që do të duhet të kalojnë në vetim. Ne e kemi një proces vetimi në zhvillim e sipër, që është ai i cili ka të bëjë me gjithë prokurorët, gjyqtarët, këshilltarët e të tjerë me radhë, dhe vetëm një e teta e tyre është arritur të vetohet. Pra, është një proces, që duhet ta pranojmë se kërkon kohë, kërkon objektivitet, kërkon financë e të gjitha me radhë, por me ligjin “Për vetingun” ne pretendim të krijojmë ca institucione të reja të vetingut. Ato institucione që ne njohim, si KPK-ja apo Kolegji i Apelit, janë organe kushtetuese, ndërkohë që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit në rastin e Policisë së Shtetit nuk është një organ kushtetues, por një organ i krijuar me ligj. Kjo sepse ne, si ligjvënës, këtë fuqi kemi dashur të jepnim. Deri këtu.

A është çështja e shpenzimeve dhe e kostove një çështje e rëndësishme? Patjetër që është. Policia e Shtetit ka shumë nevoja. Ne, si anëtarë të këtij komisioni, kemi qenë në një shumicë dërmuese të institucioneve të sigurisë dhe i kemi parë nga afër njerëzit, drejtpërsëdrejti. Patjetër që ka nevojë për buxhetim, dhe mua më vjen mirë që qeveria e ka bërë këtë gjë. Nga ana tjetër ka nevojë për vëmendje. Në ç’kuptim? Në kuptimin që, nëse ti buxhetorësh më mirë, duhet që edhe buxhetin ta orientosh te prioritetet. E në fakt, detyra jonë kjo është. Ne e dëgjojmë një herë në vit institucionin e Ministrisë së Brendshme për buxhetin, por ama nuk duhet të anashkalojmë nga

përgjegjësitë tona, që përgjatë gjithë vitit të kujdesemi të vëmë në vëmendje të këtij institucioni buxhetimin sipas nevojave, që bazuar edhe në atë që ne prekim, për shkak të punës sonë, duken prioritare. Sigurisht, për Policinë e Shtetit është prioritare lufta kundër krimit, sot e përgjithmonë. Kjo nuk e ka emrin as PD, as PS, LSI e as ndonjë parti tjetër. Kjo është një luftë, e cila organizohet për të mbrojtur rendin dhe sigurinë publike, gjë që natyrisht shkon në favor e në interes të qytetarëve.

Kështu, duke dashur ta mbyll diskutimin tim, i cili besoj bëhet pjesë e të gjitha qëndrimeve që u shprehën nga anëtarët e këtij komisioni, unë do t'i ftoj kolegët që ta shprehim me votë qëndrimin tonë ndaj dekretit të Presidentit të Republikës.

Tani do të më duhet t'ju ftoj që të votoni.

Kush është dakord me dekretin e Presidentit të Republikën për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 20 të vitit 2019.

Ka vetëm tre anëtarë të opozitës, që janë dakord.

Kush është kundër dekretit të Presidentit të Republikën për kthimin për rishqyrtim të ligjit?

Atëherë rrëzohet me shumicë votash dekreti i Presidentit të Republikën,

Faleminderit të gjithë të ftuarve për prezencën e për kontributin në këto diskutime!

Ditën të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**